



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 13/11/2023

PROCES VERBAL

Konsultimi për Buxhetin dhe Paketën Fiskale

Vendi : Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Përmet

Ora : 12:00

Tema e konsultimit : Kerkesat e te rinjve dhe Buxheti i Bashkise per vitin 2024.

I mbajtur sot më datë 13 Nëntor në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, po zhvillohet kjo mbledhje ku marin pjesë Kryetarja e Bashkisë Përmet, znj.Alma Hoxha, Anëtarët e Këshillit Vendor Rinor dhe nxënës të gjimnazit “Sami Frashëri”.

Fjalën hapëse të takimit e mori anëtarja e Këshillit Vendor Rinor, Megi Ibrahimimi e cila shprehu në emër të gjithë nxënësve falenderime dhe mirënjohje për Bashkinë Përmet që po i mbështet në çdo aktivitet që ata organizojnë.Më pas ajo shprehu disa nga kërkesat të cilat janë më të nevojshme për organizimin e një nga aktiviteteteve më të rëndësishme për ta siç është RinFest, si më poshtë :

1. PËRZGJEDHJA E NJË PËRSONI PËR ORGANIZIMIN DHE MBARËVAJTJEN E AKTIVITETIT “RINFEST 2023”
2. CAKTIMI I NJË HAPËSIRE PËR ZHVILLIMIN E PROVAVE TË AKTIVITETIT
3. MBËSHTETJE LOGJISTIKE PËR GJITHË AKTIVITETIN
4. MBESHTETJA E AKTIVITETEVE TE TE RINJVE ME BUXHETIN E VITIT 2024

Pas përfundimit të fjalës së nxënëses Megi Ibrahimimi, fjalën e mer Kryetarja e Bashkisë Përmet, znj.Alma Hoxha.Fillimisht ajo i përgëzon të rinjtë e qytetit për iniciativën dhe dëshirën e tyre për të gjallëruar jetën kulturore dhe artistike të qytetit të Përmetit.Ajo u garantoj të rinjve mbështetje maksimale nga ana e Bashkisë për të bërë të mundur zhvillimin e këtij aktiviteti.

Gjithashtu znj.Alma Hoxha u kërkoi të rinjve angazhimin e tyre maksimal në vijim pranë Qendrës Rinore e cila do të jetë në funksion të tyre pasi të përfundojë plotësisht rikonstrukcionin.Ajo theksoi se me përfundimin e kesaj qëndre tërësisht të rinovuar, kërkohet nga ana e tyre pjesëmarrje akoma dhe me e madhe pasi aty do të kenë mundësi që gjithësecili prej tyre të ushtrojë talentin që ka.

Fjalën e mori përsëri nxënësjja Megi Ibrahimimi, e cila siguroi se së bashku me të rinjtë e tjerë do ta kthejnë atë qëndër në një vend i cili do të tërheqë gjithnjë e më shumë të rinj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Në fund të takimit, znj. Alma Hoxha u shprehu të rinjve edhe një herë gatishmërinë e saj për të mbështetur çdo ide dhe projekt që vjen nga të rinjtë e qytetit të Përmetit.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURO